



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:094343
Datë: 24.06.2024
Numri i dokumentit: 05853282

Ac.nr.5177/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Nora Bllaca-Dula, kryetare e kolegjit, Arsim Hamzaj dhe Rafet Haxhaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses NPB sh.a me seli në P....., U....., rr. “.....”, nr....., të cilën e përfaqëson me prokurë V.B, avokat në Prishtinë, kundër të paditurit A.K nga P....., rr. “.....” në P....., të cilin e përfaqëson me prokurë F.Q, avokat në Prishtinë, për shkak të pengim posedimit, duke vendosur sipas ankesës së paditëses e paraqitur kundër aktvendimeve të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3496/20, i datës 23.06.2023 dhe aktvendimin C.nr.3469/20 të datës 20.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHEN të pathemelta ankesat e paditëses NPB sh.a, me seli në P....., U....., rr. “.....”, nr....., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3496/20, i datës 23.06.2023 dhe aktvendimi C.nr.3469/20, i datës 20.07.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e ankimuar C.nr.3496/20, i datës 23.06.2023, ka vendosur si në vijim: *“KONSIDEROHET SE ËSHTË TËRHEQUR padia e paditëses NPB sh.a me seli në P....., kundër të paditurit A.K nga P....., në këtë çështje juridike të pengim posedimit”*.

Ndërsa me aktvendimin plotësues C.nr. 3496/20, i datës 20.07.2023, është vendosur: “ I. Aprovohet e bazuar kërkesa e palës së paditur për shpenzimet e procedurës në çështjen juridike kontestimore C.nr. 3496/20. II. Detyrohet paditësja NPB sh.a. me seli në Prishtinë, që të paditurit A.K nga P..... t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 644.00 €, në afat prej 16 ditësh nga marrja e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.”

Kundër këtyre aktvendimeve paditësja përmes të autorizuarit të saj, në afat ligjor ka paraqitur ankesë duke mos theksuar shkaqet ankimore të parapara me dispozitat e LPK-së, me propozim që aktvendimet e atakuara të prishen dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar i padituri.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimet e atakuara, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesat e palës paditëse janë të pathemelta.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja përmes të autorizuarit të saj, në gjykatën e shkallës së parë me dt. 03.10.2018 ka paraqitur padi kundër të paditurit, për shkak të pengimit të posedimi të lokalit afarist nr..... (tani nr.....) i cili gjendet në rr. “.....”- tani rr. ‘.....’ në P..... në sipërfaqe prej 14.45 m2.

Gjykata me qëllim të shqyrtimit të kërkesëpadisë së paditësve, e ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor me dt. 23.06.2023 me fillim në ora 13:30 dhe palët janë ftuar me ftesa të rregullta gjyqësore. Seanca e shqyrtimit kryesor me dt. 23.06.2023 ka filluar në ora 13:45 dhe ka përfunduar në ora 14:15, ndërsa përfaqësuesi me prokurë i paditësës nuk mori pjesë në këtë seancë, sipas thirrjes së gjykatës. Nga procesverbali i seancës së dt. 15.05.2023, gjykata konstatoi se përfaqësuesi i paditësës për seancën e dt. 23.06.2023 me fillim nga ora 13:30, është ftuar në mënyrë të rregullt, i cili e ka pranuar dhe e ka nënshkruar procesverbalin e datës së lart theksuar i cili i shërben si ftesë e rregullt, i cili pranimin e ka konfirmuar me nënshkrimin e procesverbalit të theksuar.

Përfaqësuesi i paditësës av. V.B nga Prishtina, me parashtresën e dorëzuar në gjykatë me dt.12.06.2023, ka kërkuar që seanca e dt. 23.06.2023 të shtyhet për një datë tjetër, me arsyetim se i njëjti do të udhëtoj në shtetin e Francës, ku do të qëndroj deri në fillim të muajit të ardhshëm, me kërkesë për caktimin e seancës për një datë tjetër, duke bashkangjitur kopjen e biletës së udhëtimit. Duke qenë se përfaqësuesi i paditësës me parashtresën e dt.12.06.2023 ka kërkuar që seanca e dt. 23.06.2023 të shtyhet për një datë tjetër, por gjykata konstatoi se për këto pretendime i njëjti nuk ka bashkangjitur asnjë provë juridikisht të vlefshme për shtyrjen e kësaj seance. Ndaj gjykata e refuzoi kërkesën për shtyrjen e seancës, me arsyetimin se në rastin konkret avokati nuk paraqiti asnjë provë juridikisht të vlefshme dhe se pretendimi i të njëjtit nuk paraqet rrethanë e cila nuk mund të parashikohet e as të parandalohet. I padituri kishte propozuar që seanca të mos mbahej në mungesë të paditësës, andaj gjykata në mungesë të arsyeve për mos prezencë në seancë, në kuptim të dispozitës së nenit 423 paragrafi 3, të LPK-së, ka vendosur që padia e

paditësit të konsiderohet e tërhequr, ndërsa për shpenzimet e procedurës kontestimore ka vendosur konform nenit 452.2 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi dhe aktvendimi plotësues të atakuar nuk janë përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkelje Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nuk i pranon pretendimet ankimore për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për arsye se dispozitivi i aktvendimit është i qartë dhe i përmbarueshëm, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.

Përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm pasi që me dispozitën e nenit 423 paragrafi 3 të LPK-së shprehimisht parashihet se *“Në qoftë se paditësi nuk vjen në seancën kryesore, edhe pse është thirrur rregullisht, konsiderohet se e ka tërhequr padinë, përveçse kur i padituri deklaron se kërkon që të zhvillohet shqyrtimi kryesor i çështjes në mungesë të paditësit”*. Sipas kësaj dispozite përcaktohen pasojat ligjore për mungesën e palës paditëse në seancën e shqyrtimit kryesor, e që tërheq prezumimin e tërheqjes së padisë, sepse padia për tu konsideruar e tërhequr duhet të plotësohen kushtet ligjore, si mungesa e paditësit, të jetë ftuar në mënyrë të rregullt dhe mungesa e tij të mos jetë e arsyetuar.

Në rastin konkret fakti se pala paditëse ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullt dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, konstatohet nga procesverbali i seancës së dt. 15.05.2023, ku drejtë gjykata ka konstatuar se përfaqësuesi i paditëses për seancën e dt. 23.06.2023 me fillim nga ora 13:30, është ftuar në mënyrë të rregullt, i cili e ka pranuar dhe e ka nënshkruar procesverbalin e theksuar, i cili i ka shërbyer si ftesë e rregullt dhe pranimin e kishte konfirmuar me nënshkrimin e procesverbalit të theksuar. Përfaqësuesi i paditëses av. V.B nga Prishtina me parashtresën e dorëzuar në gjykatë me dt.12.06.2023, ka kërkuar që seanca e dt. 23.06.2023 të shtyhet për një datë tjetër, me arsyetim se i njëjti do të udhëtoj në shtetin e Francës, ku do të qëndroj deri në fillim të muajit të ardhshëm, me kërkesë për caktimin e seancës për një datë tjetër, duke bashkangjitur kopjen e biletës së udhëtimit nga e cila rezulton se i njëjti ka udhëtuar me dt. 09.06.2023, të cilën gjykata e refuzoi të pabazuar, prandaj përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm.

Gjykata e Apelit i ka vlerësuar pretendimet ankimore të palës paditëse, respektivisht të autorizuarit të saj, se i njëjti është dashur të udhëtojë për shkaqe shëndetësore, por që kjo gjykatë ka vlerësuar se i njëjti nuk ka bashkangjitur asnjë provë që do ta arsyetonte udhëtimin e tij për shkaqe shëndetësore, ndërsa është vërtetuar fakti se i njëjti është ftuar në mënyrë të rregullt për seancën e radhës, nuk ka prezantuar dhe parashtresës së dt.12.06.2023, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e seancës, nuk i ka bashkangjitur asnjë provë juridikisht të vlefshme për shterjen e seancës.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur e ka detyruar paditësin në kompensimin e shpenzimeve procedurale të paditurit, për arsye se meqë gjykata e shkallës së parë ia ka konsideruar të tërhequr padinë, si në aktvendimin C.nr 3496/20 i dt. 23.06.2023, ndërsa në seancën e dt. 23.06.2023 pala e paditur i ka kërkuar shpenzimet e procedurës, andaj sipas dispozitës së nenit 454 par.2 të LPK-së, andaj gjykata e detyron palën paditëse, që palës së paditur t'ia paguaj shpenzimet e procedurës, si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, në shumë të përgjithshme prej 644.00€.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të paditësit, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për të marr një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) e LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.5177/2023, datë 24.06.2024

Kryetare e kolegjit
Nora Bllaca Dula, d.v.